

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Dogana e Kosovës

Për Aktivitetin e Prokurimit:

|                 |                         |
|-----------------|-------------------------|
| Nr i Prokurimit | 201 13300-20-2108-1-1-1 |
| Nr i brendshëm  | 2011.133.20.023.111     |

Sa i përket tenderit për: "Furnizim me pllomba për Doganën e Kosovës"

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Be New LLC"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr Tahir Zajmi nn

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

044537903

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Bujar Shkodra

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)t

info@benew-ks.com & benewllc@gmail.com

(Adresa elektronike)

07.04.2021

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vulë)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.



### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

21.09.2020 është publikuar njoftimi ne platformën elektronike  
06.10.2020 ka qene afati i fundit për ofertim  
23.11.2020 është publikuar njoftimi mbi Vendimin e AK per rekomandim te kontratës-Be New LLC  
30.11.2020 është publikuar Vendimi mbi pezullimin pas kërkesës per rishqyrtim nga nje OE tjetër  
06.01.2021 është publikuar njoftimi mbi Vendimin e AK per rekomandim te kontratës-Be New LLC  
20.01.2021 është publikuar vendimi per pezullim,  
02.03.2021 është publikuar njoftimi per anulim te vendimi per rekomandim te kontrates  
25.03.2021 është publikuar njoftimi mbi Vendimin e AK per rekomadim te kontratës-OE tjetër  
29.03.2021 kemi kërkuar rishqyrtim te vendimit  
02.04.2021 është publikuar vendimi për refuzim te kërkesë për rishqyrtim

- Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

#### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Te bashkëngjitur gjeni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin për refuzim të kërkesës*

#### **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**NENI 1; 7; NENI 59 dhe NENIT 60**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

#### **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

AK-ka vepruar në kundërshtim me LPP-ne pasi që oferta e jone ka qenë e përgjegjshme dhe me çmimin me lire dhe rrjedhimisht do duhet të shpallej fituese dhe ndërsa AK me njoftimin e vendimin për rekomandim të kontratës një OE tjetër me çmimin me shtrenjtë ka shkelur Ligjin për prokurim Publike me saktësisht NENET e shënuara me lartë për këto arsye:

AK ka vepruar në kundërshtim me NENIN 1, pasi që nuk u sigurua mënyra më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike duke dëmtuar buxhetin për 11,300.00€

AK ka vepruar në kundërshtim me NENIN 7, pasi që me vendimin për dhënie të kontratës ka diskriminuar ofertën tonë duke mos e trajtuar të barabartë në kërkesat e dosjes dhe ligjeve në fuqi.



AK ka vepruar ne kundërshtim me NENIN 59 , pasi qe oferta e jonë i ka plotësuar te gjitha kriteret e kërkuara ne dosje te tenderit dhe duke ofruar çmimin me te lire dhe si rezultat i saj do duhej te shpallet fituese ashtu edhe siç kishin vendosur dy komisionet e para .

AK ka vepruar ne kundërshtim me NENIN 60, pasi qe oferta jone i ka plotësuar te gjitha kriteret e dosjes dhe specifikat teknike te produktit dhe arsyetimet e komisionit rivlerësues nuk qëndrojnë për këto arsye:

Ne dosjen e tenderit me saktësisht tek ANEX 1 faqe 21 ka shkruar qarte : **Udhëzime te përgjithshme për operatorët ekonomik**

Tenderuesi me rastin e dorëzimit te tenderit nuk është i obliguar qe ta dorëzoj mostrën me logon e Doganës dhe numrin tetë shifror, mirëpo tenderuesit të cilit i rekomandohet dhënia e kontratës është i obliguar qe brenda 7 ditëve kalendarike pas kërkeses se AK t'ia dorëzoj mostrën e plombes me specifikat si logo te Doganës dhe numrin tetë shifror e cila mostër do të pranohet nëse i plotëson kushtet sipas specifikimit teknik.

Mosplotësimi i këtij kushti nga tenderuesi i rekomanduar për kontrate bën që oferta e tij të refuzohet.

Përveç këtij sqarimi ne dosje , me datën 08.06.2020 është publikuar sqarimi shtese me datën 08.06.2020 si dokument ANEKS 5 ku ne sqarimet pikës 7 shkruan:

**Nr. 7. Sqarimi i AK:** OE me rastin e dorëzimit të tenderit nuk janë të obliguar të dorëzojnë mostrën fizike të pllombes. Mostra fizike e pllombes do të kërkohet vetëm nga tenderuesi te cilit i rekomandohet dhënia e kontratës gjate fazës se vlerësimit të tenderit. Pra, tenderuesit të cilit i rekomandohet dhënia e kontratës është i obliguar qe brenda 7 ditëve kalendarike pas kërkesës se **AK t'ia dorëzoj mostrën e plombes me specifikat si logo te Doganës dhe numrin tetë shifror**, e cila mostër do të pranohet nëse i plotëson kushtet sipas specifikimit teknik. Mosplotësimi i këtij kushti nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë bën që oferta e tij të refuzohet.

Me datën 02.12.2020 përmes emailit na është kërkuar te dorëzojmë mostrën dhe e kemi dorëzuar ditën e nesërme ( brenda afati prej 7 ditëve), qe është ne pajtim te plote me kërkesën e dosjes se tenderit -ANEX 1.

Duke marre për baze kërkesën e AK me saktësitë ANEX 1 faqe 21 dhe Anexi nr 5 sqarimi nr 7, ne gjate ofertimit kemi bashkëngjitur deklaratën mbi specifikat teknik te mostrës dhe pas kërkesës për dorëzim te mostrës ne i kemi dorëzuar mostrën me specifika 100% te sakta siç është kërkuar ne dosje dhe me dy testime ( njeri nga prodhuesi dhe tjetri nga instituti i specializuar për testime te tilla profesionale "Dalekovod" Kroaci , testim i cili është bere kryesisht per qëllime personale te biznesit ne mënyrë qe te ri konfirmohet kualiteti i produktit dhe kete e kemi sqaruar edhe tek AK gjate sqarime qe te kerkuara ) ky te dyja dëshmojnë qarte se produkti është testuar sipas ISO 17712:2006 apo 2013 dhe ka rezultuar qe te jete me cilësi te larte .

Arsyetimi për elimin te ofertës tone është krejtësisht i paqëndrueshëm pasi ne kemi dorëzuar mostrën me kohe dhe sipas kërkesës se dosjes se tenderit , andaj çdo përpjekje për te kuptuar ndryshe nga ajo qe është e shkruar qarte ne faqen 21 te ANEX 1 dhe Anexi nr 5 sqarimi nr 7, është e kundërligjshme , diskriminuese dhe e dëmton buxhetin e republikës dhe cenon interesat e kompanisë tone.

Arsyetimi për elimin për gjoja te dorëzimit te raportit testues pas dorëzimit te ofertave është i pa qëndrueshëm krejtësisht për këto arsye:

Ne asnjë pjese te dosjes nuk është kërkuar qe atestet duhet te dorëzohen gjate ofertimit pasi qe kjo bie ndesh edhe me kërkesat tek ANEX faqe 21 dhe sqarimet shtese sipas Anexi nr 5 sqarimi nr 7, ku kërkohet qe : OE me rastin e dorëzimit të tenderit nuk janë të



obliguar të dorëzojnë mostrën fizike të pllombes. Mostra fizike e pllombes do të kërkohej vetëm nga tenderuesi te cilit i rekomandohet dhënia e kontratës gjatë fazës së vlerësimit të tenderit. Pra, tenderuesit të cilit i rekomandohet dhënia e kontratës është i obliguar që brenda 7 ditëve kalendarike pas kërkesës së **AK t'ia dorëzoj mostrën e pllombes me specifikat si logo të Doganës dhe numrin tetë shifror**, e cila mostër do të pranohet nëse i plotëson kushtet sipas specifikimit teknik. Mosplotësimi i këtij kushti nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë bën që oferta e tij të refuzohet

**Përfundimi:**

Me që dy komisionet e para kanë vepruar në respektim të ligjit për prokurim publik dhe kanë shpallur dy here ofertën tone fituese për faktin që kemi paraqitur oferte të përgjegjshme dhe me çmim më të lirë, ndërsa refuzimi i ofertës tonë lenë të kuptohet se është bazuar në vendimin e OSHP-së, konsiderojmë se është i paqëndrueshëm për faktin që OSHP-ja në këtë rast është vënë në lajthitje nga ana e ekspertit shqyrtues për fatin e keq tonin, nuk e ka konsultuar fare dosjen e tenderit dhe sqarimet që ka bërë AK, me saktësisht dosjen e tenderit- kërkesat teknike ANEX faqe 21 dhe Anexi nr 5 sqarimi nr 7 i publikuar në platforme të prokurimit më datën 08.06.2020, ku shkruan qartë dhe saktë: OE me rastin e dorëzimit të tenderit nuk janë të obliguar të dorëzojnë mostrën fizike të pllombes. Mostra fizike e pllombes do të kërkohej vetëm nga tenderuesi te cilit i rekomandohet dhënia e kontratës gjatë fazës së vlerësimit të tenderit. Pra, tenderuesit të cilit i rekomandohet dhënia e kontratës është i obliguar që brenda 7 ditëve kalendarike pas kërkesës së **AK t'ia dorëzoj mostrën e pllombes me specifikat si logo të Doganës dhe numrin tetë shifror**, e cila mostër do të pranohet nëse i plotëson kushtet sipas specifikimit teknik. Mosplotësimi i këtij kushti nga tenderuesi i rekomanduar për kontratë bën që oferta e tij të refuzohet. Ku nëse OE e kemi dorëzuar mostrën në përputhje të plotë me këtë dhe konsiderojmë fuqishëm se oferta e jone është e përgjegjshme dhe ka çmimin më të lirë dhe duhet të jetë fituese e këtij tenderi.

Kërkojmë nga OSHP që të aprovojë pretendimet tona ankimore dhe lenden të kthejë në ri-vlerësim dhe të detyrojë AK që të rivlerësojë ofertat në pajtim me kriteret e shkruara në dosje dhe me sqarimin e publikuar në e-prokurim për këtë projekt me saktësisht ANEX 5, sqarimi nr 7 e këtij dokumenti.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Demet materiale janë 45,000.00€ duke llogaritur vetëm fitimet e humbura nga kjo kontratë duke mos e llogaritur angazhimet dhe shpenzimet tjera**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.